



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORATI PËR BUJQËSI , PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL**

**Reference: 12-320**

<b>Datë:</b>	<b>05.09.2017</b>
<b>Për:</b>	<b>z.Imri AHMETI - Kryetar i Komunës së Lipjanit</b>
<b>Nga:</b>	<b>Feti KRASNIQI -Drejtore i Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural</b>
<b>Lënda:</b>	<b>Raporti mujor i punës për muajin Gusht : 2017</b>

**Shtojcë:** Raporti i aktiviteteve të Drejtoratit për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural për muajin Gusht : 2017

**DBPZHR ne Lipjan gjatë muajit Gusht 2017 , ka zhvilluar këto aktivitete :**

**Aktivitete profesionale :**

- Takimet javore në Bordin e Drejtorëve
- DBPZHR përmes komisionit perkates ka dalë në teren për vlerësimin e kërkesave per përkrahje ne serra dhe makina mjelëse.
- DBPZHR-ka mbajtur takime pune me Stafin punues dhe Fermer me qellim te vlerësimit te detyrave te punes dhe pergjegjesive ne punë.

Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Komunën e Lipjanit, së bashku me IADK, kanë mbajtur takimin informues në sallën e kuvendit komunal me datën 29 .08.2017 . Po te njejten ditë janë nënshkruar kontratat për 21 perfitues nga IADK-ja në bashkëpunim me GIZ,-in Gjerman.

Për të gjithë përfituesit është hartuar një plan i trajnimeve me qellim që secili përfitues para se të ngritë serren apo pemishten te kete informatat më te reja profesionale.

Ndersa në sektorin e pylltarisë gjatë këtij muaji janë regjistruar mjaft zjarre në terene pyjore ne te cilat jane perfshi 36 hektar nga te cilat 27 hektar pyje shtetërore dhe 9 hektar në pyjet private.

DBPZHR, ka hartuar një plan operative për kontrollin e prerjeve ilegale , dhe të njëjtin e ka derguar në stacionin policor në Lipjan , Janjevë dhe Magure , me qellim te përkrahjes dhe bashkëpunimit institucional.